



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
**Kuvendi - Skupština - Assembly**

---

**Legjislatura III**  
**Sesioni pranveror**

Komisioni për Mbikëqyrje të Financave Publike  
Dëgjimi publik nr. 02  
Prishtinë, më 30 qershor 2010, në orën 14: 00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

**PROCESVERBAL**  
**I DËGJIMIT PUBLIK TË KOMISIONIT PËR MBIKËQYRJE TË FINANCEVE**  
**PUBLIKE**

**Në dëgjim publik morën pjesë:** Haki Shatri, Safete Hadergjonaj, Kosara Nikoliq, Gani Koci, Naser Osmani, Riza Smaka, Synavere Rysha dhe Enis Kervan.

**Mungoi:** Anita Morina – Saraçi.

**Nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm:** Çerkin Morina - zv.auditor i përgjithshëm dhe Enver Ramadani – auditor.

**Nga Kuvendi Komunal i Prishtinës:** Agim Dibrani.

**Nga NQ “Termokos Prishtina”:** Fëllanze Pula – kryeshefe ekzekutive, Nexhmedin Beha, Gani Kelmendi, Driton Hyseni, Ilir Azemi dhe Astrit Shyti.

**Të pranishëm:** nga Zyra e Komisioneve të Kuvendit, Fatime Qorri – zyrtare ligjore, Musa Rudaku – zyrtar i fushës së ekonomisë dhe të financave, nga KIPRED-i (staf mbështetës), Artan Venhari dhe Albert Krasniqi, Shpresa Miftari – praktikante, nga Zyra e Presidentit - Nexhat Shatri nga NDI-ja, Rinor Beka, nga KDI-ja, Besnik Ramadanaj, nga ZAP-i, Qëndresa Mulaj.

**Dëgjimin e kryesoi z.** Haki Shatri - kryetar i Komisionit.

**Rend i ditës:**

**Shqyrtimi i Raportit të Auditimit për menaxhimin financiar të NQ “Termokos Prishtina” për vitin që përfundoi, më 31dhjetor 2009.**

**Kryesuesi** – I njoftoi të pranishmit për rregullat e seancës dëgjimore. Deputetët, anëtarë të këtij Komisioni, mund të parashtrojnë pyetje. Diskutimi i deputetëve do të jetë i kufizuar, maksimalisht dhjetë minuta. Hapi dëgjimin publik.

**Çerkin Morina - zv.auditor i përgjithshëm** – I njoftoi anëtarët e Komisionit me kronologjinë e auditimit. ZAP-i është përcaktuar për auditimin e menaxhimit financiar të kompanisë dhe si objektivi i ka pasur verifikimin e të dhënave kontabël, procedurat e kontrollit të brendshëm dhe gjenerimet e të gjitha të dhënave, që i posedon kompania. Me rishikimet e auditimit për 30 ditë pune janë konstatuar dobësi në kontrollet e brendshme, të cilat për rezultat kanë pasur disa gjetje të auditimit. Vlen të cekem dy prej tyre: *sasia e shpenzimeve të mazutit, e cila, krahasuar me vitin 2008, ka qenë 50% më e lartë gjatë vitit 2009. Pastaj, furnizimi me derivate ku kompania*

*“Termokos” nuk i është përmbajtur kontratës për furnizim, domethënë nuk i është përmbajtur çmimit të berzës. ZAP-i ia ka dorëzuar raportin “Termokosit”, menaxhmenti i të cilit ka dhënë komente dhe Raporti ka ndryshuar në ato pika ku ka konsideruar se ka përmirësime.*

**Gani Koci** – Cilët janë auditorët që e kanë bërë auditimin e kësaj kompanie? A ka pasur konflikt ndërmjet Enver Ramadanit (auditor) dhe “Termokosit”? A ka kontest gjyqësor në gjykatë ndërmjet të Enver Ramadanit dhe “Termokosit”? Cilat janë shkeljet, për të cilat Enver Ramadani është larguar nga “Termokosi”? Cilën punë e kryen Ymer Vitia në ZAP? A ka konkurruar gjatë kohës së auditimit të “Termokosit” për auditor të brendshëm dhe a është pranuar?

Nga kjo del se krejt procesin e auditimit e kanë udhëhequr personat që kanë qenë në konflikt interesi me “Termokosin”. Bazuar në këto, vlerësimet e këtij Raporti mund të jenë subjektive. Propozoi që ZAP-i ta bëjë një auditim me një ekip tjetër, duke e përjashtuar kështu konfliktin e interesit. Përderisa ekzistojnë këto të dhëna - ekziston konflikti i interesit dhe çdo shqyrtim i mëtejshëm i këtij Raporti është i pakuptimtë.

**Çerkin Morina - zv.auditor i përgjithshëm** – Auditimin në “Termokos” e ka udhëhequr Enver Ramadani, i cili me kohë e ka informuar ZAP-in se ka punuar si drejtor financiar në këtë kompani dhe ka dashur të tërhiqet nga ky auditim. Mirëpo, auditori i përgjithshëm, ka vlerësuar se ajo çështje është vjetërsuar dhe në bazë të standardeve të auditimit nuk ka konflikt interesi në këtë rast. Lidhur me Ymer Vitinë, tha se është udhëheqës i drejtpërdrejtë i Enver Ramadanit, i cili ka konkurruar për auditor të brendshëm në Termokos dhe për këtë e ka njoftuar ZAP-in. Nga ky moment ZAP-i e ka suspenduar nga ky auditim.

**Enver Ramadani** – Tha se gjatë kësaj kohe nuk ka pasur informatë nëse kishte kontest gjyqësor ndaj tij. Ai konsideron se nuk ka bërë shkelje gjatë punës në këtë kompani?

**Gani Koci** – Shkeljet për të cilat Enver Ramadani është larguar nga Termokos janë: vonesa në furnizim me material të ndërmarrjes me ç`rast i është shqiptuar vërejtja, moskryerja e rregullt e regjistrimeve vjetore dhe atë të regjistrimit të depos, mjeteve themelore, inkasantëve dhe inventarit, vonesa e faturimit të lokalit banesor dhe afarist e që dëshmohej me urdhëresën e punës. I përmenduri nuk ka dhënë sqarime lidhur me informatën e shërbimit për konsumatorë dërguar drejtorit lidhur me pagesën e lokalit afarist. Drejtori i ndërmarrjes lidhur me këtë çështje, ka kërkuar nga udhëheqësi i shërbimit ekonomik – financiar, sqarime lidhur me atë se cilët punëtorë kanë mbajtur dhe mbajnë blloqet për pagesën e ngrohjes nga lokali afarist, por sqarimet nuk janë dhënë. Për këto shkelje ka kontest gjyqësor të krimeve të rënda ekonomike. Prandaj, çdo shqyrtim i mëtejshëm i këtij Raporti është i pakuptimtë.

**Kryesuesi** - Përderisa Komisioni nuk ka një vendim të një organi kompetent, lidhur me çështjet e ngritura në këtë Komision, në bazë të dyshimeve nuk mund të merren vendime. Për dilemën nëse raporti është valid ose jo, nuk ka çka të bisedohet. Raporti u është shpërndarë me kohë të gjithë anëtarëve të Komisionit dhe deri më sot nuk ka pasur asnjë vërejtje. Kërkoj nga anëtarët e Komisionit të vazhdojnë me shqyrtimin e këtij Raporti dhe propozoj që gjatë shqyrtimit të mëtejshëm Komisioni të kërkojë deklaratë nga auditori i përgjithshëm lidhur me vërtetësinë e tij.

**Naser Osmani** – Tërhoqi vërejtjen se Komisioni nuk mund të vazhdojë me shqyrtimin e këtij Raporti, përderisa nuk janë zgjidhur çështjet procedurale nga Komisioni. Në këtë takim u dhanë dy propozime, për të cilat duhet të vendosë Komisioni. Raporti është dorëzuar me kohë te të gjithë anëtarët e Komisionit, por në këtë takim dolën shumë dokumente të reja, të cilat asnjë anëtarë i Komisionit nuk i kishte në dispozicion për t'i shqyrtuar.

**Riza Smaka** - Pasi mori përgjigjen nga zv.auditor i përgjithshëm se i duhen 20 ditë pune për ta bërë një auditim të ri, me një ekip tjetër audituese, tha se Komisioni duhet të kërkojë nga ZAP-i, që urgjentisht ta formojë një ekip tjetër audituese. Çështja duhet të shtyhet për një periudhë njëmuajore.

**Synavere Rysha** – Raporti ka mjaft për t’u diskutuar. Ka të gjetura të mëdha, të cilat i ka pranuar edhe menaxhmenti i “Termokosit”. Kjo kompani menaxhon miliona euro dhe brenda vitit ka humbur më se një milion. Këtë e ka pranuar edhe menaxhmenti i kësaj kompanie. Aty ku ka inkasuar kompania e ka paraqitur gjendjen reale. Po ashtu pasqyrat financiare janë paraqitur realisht, mirëpo përsëri ka mospërputhje - *fjala është për një milion e gjysmë euro*. Mungon një veturë “Pezho 407”, për të cilën nuk ka arsyetim nga menaxhmenti. Më mirë do të ishte që Komisioni të fokusohet në këto çështje, e jo të kontestojë çështje, të cilat duhet të trajtohen nga organe të tjera. Kushtet ligjore janë përmbushur. Kanë kaluar më tepër se tre vjet nga koha kur udhëheqësi i ekipit auditues ka punuar në këtë kompani, ndërsa kontesti gjyqësor ka filluar dy muaj pasi ka filluar auditimi i kësaj kompanie.

**Kosara Nikoliq** – Nga Raporti shihet se Komisioni ka për çka të debatojë, mirëpo nuk mund të debatohet për një ose për dy çështje të këtij Raporti e të mos debatohet për Raportin në tërësi. Çështja e konfliktit të interesit mund të zgjidhet vetëm nga ZAP-i, prandaj Komisioni duhet të kërkojë nga ZAP-i, që të procedojë raport të ri të auditimit, në kohë sa më të shkurtër.

**Enis Kervan** – U pajtua me mendimin se ka mjaft gjëra për të diskutuar lidhur me këtë Raport, mirëpo meqenëse shumica e anëtarëve të Komisionit ishin të të njëjtit mendim, tha se i bashkohet mendimit të shumicës.

**Safete Hadergjonaj** – Tha se është shumë e disponuar t’u besojë raporteve të auditorit, mirëpo meqenëse në mbledhje u paraqit materiali, për të cilin anëtarët e Komisionit nuk kanë qenë të informuar, dyshon se mund të ketë subjektivizëm. Komisioni nuk ka nevojë të marrë vendime të nxituara. Fakti se udhëheqësi i ekipit auditues e ka lajmëruar auditorin e përgjithshëm lidhur me mundësinë e konfliktit të interesit, nuk u dëshmuua, sepse në këtë Komision nuk u paraqit asgjë me shkrim. Sipas rregullave të auditimit “*...personi për të cilin mund të dyshohet se ka konflikt interesi me një institucion, nuk mund ta bëjë auditimin e atij institucioni...*”. Auditori i përgjithshëm është bazuar në disa standarde lidhur me këtë, mirëpo Komisionit nuk i është sqaruar se në cilat standarde është bazuar auditori i përgjithshëm. ZAP-i mund ta dëshmojë këtë në një takim të radhës.

**Kryesuesi** – I besoi Raportit të ZAP-it. Për segmentet që mund të çojnë te konflikti i interesit, tha se Komisionit i duhet një mendim profesional, por një gjykim nuk mund ta vërë në dyshim këtë Raport. Raporti është i nënshkruar nga auditori i përgjithshëm, i cili e merr përgjegjësinë për vërtetësinë e tij. Respektoj vullnetin e shumicës së anëtarëve të Komisionit. Mosshqyrtimi i këtij raporti është mungesë e një vullneti për ta penguar keqpërdorimin e parasë publike.

Kryesuesi konstatoi se KMFP-ja me shumicë votash e nxori këtë

## **PËRFUNDIM**

1. Kërkohet nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm ta përgatitë një raport tjetër të auditimit, me një ekip tjetër, lidhur me menaxhimin financiar të NQ “Termokos Prishtina”, për vitin që përfundoi më 31dhjetor 2009”.
2. Afati i fundit për procedimin e këtij Raporti në Kuvendin e Kosovës, përkatësisht në Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave Publike, është fundi i korrikut.

Dëgjimi përfundoi në orën 15:10

### **E përgatiti:**

**Njësia për mbështetjen e Komisionit**

**Kryetari i Komisionit**

---

**Haki Shatri**